



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 39 Prot

Tiranë, më 14.04.2008

VENDIM Nr. 8 dt. 08.04.2008

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 08.04.2008, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës.

**VENDOSI:**

**I. Të miratojë projektet e restaurimit:**

1. Projekt idenë e restaurimit të, Xhamisë së Mirahorit, Korçë  
Shënim: Projekti i restaurimit do të hartohet në bashkëpunim mes IMK dhe studios turke të nënkontraktuar nga Myftinia Korçë, e cila merr përsipër hartimin e projektit konstruktiv të plotësimit të minares.
2. Restaurim, kisha e Shën Mërisë, Lubonjë, Korçë.
3. Restaurim, kisha e Shën Mëhillit, Vithkuq, Korçë.
4. Restaurim, kalaja e Lezhës.
5. Restaurim, kalaja e Beratit.
6. Restaurim, Ura e Mesit, Shkodër.
7. Restaurim, kalaja e Krujës.
8. Paketa e projekteve të mirëmbajtjes së qendrës historike, Berat.
  - Sistemimi i mureve rrethues dhe oborrit të ish Selamllëkut.
  - Punime suvatimi tek Medreseja.
  - Muri i shkollës "Kala".
  - Muri M. Lapardhaja, "Kala".
  - Qoshja tek banesa e Z. Jani Prifti
  - Suvatim tek banesa e Z. Toromani.
  - Banesa Eleni Stefa (+ Furri).
9. Konservim Ikonat e Beratit. (4 ikona)
  - Vajtimi i mbivarrshëm.
  - Lindja e Shën Mërisë.
  - Kryqëzimi i krishtit.
  - E diela e Samaritanës.
10. Konservimi dhe restaurimi i pikturës së Xhamisë së Beqarëve, Berat.
11. Konsolidimit dhe restaurimit në kishën e Shën Mërisë, Katedralja e Elbasanit.
12. Punime konservuese dhe restauruese në Bazilikën e Elbasanit.
13. Restaurim, Bazilika Arapaj, Durrës.

14. Konservimi dhe ekspozimi i mozaikëve Apolloni.
15. Restaurim, rruga Justin Godart, Vlorë.
16. Restaurim dhe rivlerësim i një kompleksi monumentesh historike Durrës
  - Banesa nr. 115,
  - Hamami mesjetar,
  - Rruga "De Rada".
17. U miratua projekt - ideja e restaurimit të manastirit të Shën Kollit, Mesopotam, Sarandë.

## II. U miratuan projektet me investime nga donatorë

1. Restaurim kisha e Shën Kollit, Dhivër, Sarandë.
2. Ambiente çlodhëse në Butrint, Sarandë.

## III. Pika e diskutimit të kërkesave të liçensave:

- Miratohet kërkesa e Yllka Çaushollit, për liçensë të kategorisë B. Testuar pranë IMK për lëndët Histori e Arkitekturës Shqiptare dhe Teoria e Restaurimit të Monumenteve të Kulturës. (U kualifikua).

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
YLLI PANGÓ**



**SEKRETAR I K.K.R.**

**LORENC BEJKO**

